Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Companya Eskavatori shpk" të datës 22.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-7377-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Companya Eskavatori shpk" të datës 22.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-7377-5-2-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Companya Eskavatori shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 22.09.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-7377-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi 1: AK në DT ka përcaktuar kërkesat si në vijim:
- 2.1 Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 5 (pesë) vite përvoj pune. I licencuar nga Oda e Inxhinierëve.
- 2.8 Një (1) inxhinier i diplomuar I ndërtimtarisë ose master të përfunduar, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit
- 2.9 Një (1) Teknik i ndërtimtarisë. I certifikuar per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme inerte
Fillimisht është shumë i çuditshëm fakti se si ka mundësi që të kërkohen inxhinier dhe teknik të ndërtimtarisë për një projekt ku do të bëhet mbjellja e gjelbërimit dhe vendosja e disa produkteve (kryesisht të parafabrikuara) në mënyrë që disa hapësira të shndërrohen në parqe të qasshme (shih titullin e aktivitetin dhe paramasën/projektin). Dihet se inxhinierët e ndërtimtarisë kërkohen kur kemi të bëjmë me asfaltimin e rrugëve ose ndërtimin e objekteve shumëkatëshe dhe nuk kërkohen për krijimin e hapësirave gjelbëruese. Në rastin konkret absolutisht asnjë pozicion i paramasës dhe as titulli (apo qëllimi i aktivitetit të prokurimit) nuk e kërkon përfshirjen e këtyre personave gjatë punimeve. Pjesa më qesharake është kur jo vetëm që kërkohen inxhinierët por ata duhet të kenë edhe përvojë, shkollim dhe licensa të caktuara. Nëse ekziston një situatë në prokurimin publik kur hapurazi kërkesat e DT janë diskriminuese përkatësisht favorizuese, është pikërisht ky aktivitet i prokurimit. Për këto arsye kërkojmë nga AK që kërkesat nr. 2.1, 2.8 dhe 2.9 të FDT t'i largojë në tërësi.

Pretendimi 2: AK në DT ka përcaktuar kërkesat si në vijim:
- 2.5 Nje (1) inxhinier i Elektros, kërkohet të ketë së paku 5 vite përvoj pune i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I licencuar nga Oda e Inxhinierëve.
- 2.13 Dy (2) Teknik I elektroteknikes
Është i pashpjegueshëm fakti se si ka mundësi që të kërkohen inxhinier të elektros dhe teknik të elektroteknikës për një projekt ku do të bëhet mbjellja e gjelbërimit dhe vendosja e disa produkteve (kryesisht të parafabrikuara) në mënyrë që disa hapësira të shndërrohen në parqe të qasshme (shih titullin e aktivitetin dhe paramasën/projektin). Dihet se inxhinierët dhe teknikës e elektros kërkohen kur kemi të bëjmë me ndërtimin e objekteve shumëkatëshe dhe nuk kërkohen për krijimin e hapësirave gjelbëruese. Në rastin konkret absolutisht asnjë pozicion i paramasës dhe as titulli (apo qëllimi i aktivitetit të prokurimit) nuk e kërkon përfshirjen e këtyre personave gjatë punimeve. Pjesa më qesharake është kur jo vetëm që kërkohen inxhinierët por ata duhet të kenë edhe përvojë, shkollim dhe licensa të caktuara.
Nëse ekziston një situatë në prokurimin publik kur hapurazi kërkesat e DT janë diskriminuese përkatësisht favorizuese, është pikërisht ky aktivitet i prokurimit.
Për këto arsye kërkojmë nga AK që kërkesat nr. 2.5 dhe 2.13 të FDT t'i largojë në tërësi.

Pretendimi 3: AK në DT ka përcaktuar kërkesat si në vijim:
- 2.3 Një (1) Bachelor i Arkitektures, kërkohet të ketë min. 3 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit nga Oda e Arkitekteve.
- 2.4 Një (1) inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit dhe të ketë menaxhuar së paku një

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

projekt dhe të ofroj dëshmi për një menaxhim të tillë. I certifikuar me ISO 9001 2015-I certifikuar per testimin e produkteve. I licencuar nga Oda e Inxhinierëve.
- 2.14 Nje (1) Armirues te certifikuar
- 2.15 Nje (1) Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune.
Është i pashpjegueshëm fakti se si ka mundësi që të kërkohen inxhinier hidroteknik, arkitekt, armirues, dhe persona të tjerë të kualifikuar për ndërtimtari, në një projekt ku do të bëhet mbjellja e gjelbërimit dhe vendosja e disa produkteve (kryesisht të parafabrikuara) në mënyrë që disa hapësira të shndërrohen në parqe të qasshme (shih titullin e aktivitetin dhe paramasën/projektin). Dihet se ky lloj i personelit kërkohen kur kemi të bëjmë me ndërtimin e objekteve shumëkatëshe dhe nuk kërkohen për krijimin e hapësirave gjelbëruese.
Në rastin konkret absolutisht asnjë pozicion i paramasës dhe as titulli (apo qëllimi i aktivitetit të prokurimit) nuk e kërkon përfshirjen e këtyre personave gjatë punimeve. Pjesa më qesharake është kur jo vetëm që kërkohen inxhinierët por ata duhet të kenë edhe përvojë, shkollim dhe licensa të caktuara.
Nëse ekziston një situatë në prokurimin publik kur hapurazi kërkesat e DT janë diskriminuese përkatësisht favorizuese, është pikërisht ky aktivitet i prokurimit.
Për këto arsye kërkojmë nga AK që kërkesat nr. 2.3, 2.4, 2.14 dhe 2.15 të FDT t'i largojë në tërësi nga DT.

Pretendimi 4: AK në DT ka përcaktuar kërkesën si në vijim:
- 2.12 Nje (1) Person të trajnuar per saldim iws dhe testim sipas EN ISO 9712 2012.
EN ISO 9712:2012 nuk është standard për kualifikimin e saldatorëve, por për personelin që kryen testime NDT. Për saldatorë aplikohet EN ISO 9606-1:2018. Pra kërkesa është formuluar totalisht gabim dhe ky fakt mund të konfirmohet përmes një kërkimi të thjeshtë në internet. Për këto arsye kërkojmë nga AK që këtë kërkesë (2.12) ta largojë në tërësi nga DT ose në alternativë t'a ndryshojë duke kërkuar saktë certifikatën për saldim EN ISO 9606-1:2018.

Pretendimi 5: AK në DT ka përcaktuar kërkesën si në vijim:
Kërkesa 4.-Certifikimi EN- 1090-1 2009 A1 2011 ISO 3834-2 2021; ISO 4063 2023; ISO 9001 2015 ;ISO 14001 2015 ; ISO 27001 2013; ISO 28001 2007; ISO 39001 2012; ISO 45001 2018 ;ISO 50001 2018.
Standardet *EN- 1090-1 2009 A1 2011 ISO 3834-2 2021; ISO 4063 2023;* kanë të bëjnë me përpunimin e metaleve dhe asnjëra prej tyre nuk gjen aplikim në këtë projekt. Kjo për arsye se në paramasë nuk kemi pozicione ku kërkohet përpunimi i metaleve. Për më tepër, shumica e pozicioneve janë për mbjelljen e gjelbërimit dhe eventualisht furnizimin dhe montimin e produkteve të drurit dhe plastikës. Përndryshe, pozicionet janë kryesisht të parafabrikuara dhe në shumicën e projektit vetëm kërkohet montimi i tyre në vend. Pra këto pozicione absolutisht të panevojshme dhe si të tilla diskriminuese/favorizuese.

Ndërsa standardet tjera që janë kërkuar kanë të bëjnë me çështjet si në vijim:
ISO 27001 2013 Menaxhimi i Siguritë i Informacioneve
ISO 28001 2007 Menaxhimi i Sistemeve të Sigurisë

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

ISO 39001 2012 Menaxhimi i sigurisë në trafik
Pra të njëjtat janë totalisht jashtë cdo logjike që mund të kishte sado pak ndërlidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Cfarë nevojitet menaxhimi i sigurte i informacionit, apo i sistemeve të sigurisë kur dihet se këtu nuk po instalohen kamera të sigurisë dhe as nuk po krijohen web faqe apo platforma elektronike. Tutje, çfarë nevojitet certifikata për menaxhimin e sigurisë në trafik kur ky projekt nuk ka të bëjë me vendosjen e sinjalizimin horizontal apo vertikal në rrugë. Pra ky aktivitet ka të bëj me gjelbërim dhe lodra për parqe jo me çështje të tjera. Për këto arsye kërkojmë nga AK që kërkesën me nr. 4 ta ndryshojë duke larguar në tërësi nga FDT kërkesat për *EN- 1090-1 2009 A1 2011 ISO 3834-2 2021; ISO 4063 2023; ISO 27001 2013; ISO 28001 2007; ISO 39001 2012.*

Pretendimi 6 – AK në DT ka kërkuar po ashtu pajisje/makineri të cilat nuk kanë asnjë ndërlidhje të vetme me natyrën apo qëllimin e projektit. Asnjë nga pasjijet e listuara më poshtë nuk mund të shfrytëzohen për të realizuar qoftë edhe një pozicion të vetëm në paramasë/projekt sipas DT. Pasjijet e tilla siç janë kërkuar në DT si psh. Eskavator me lugë para dhe mbrapa, eskavator tjetër 9- 10 ton, ngarkues me pirun, damper, makinë ngjeshëse, kamion me kiper, etj, janë pajisje të cilat kërkohen vetëm në raste kur ndërtohen objekte shumë katëshe, stadiume të futbollit me kapacitet mbi 20,000 ulëse apo ndonjë auto-rrugë dhjetëra kilometra e gjatë. Mirëpo në rastin konkret kemi të bëjmë me mbjelljen e gjelbërimit dhe montimin e disa lodrave për të shndërruar disa oborre të shkollave në parqe të qasshme. Prandaj të gjitha pajisjet/makineri e evidentuara në listën më poshtë janë absolutisht diskriminuese/favorizuese dhe si të tilla në kundërshtim të plotë me LPP. Për këto arsye kërkojmë që këto pajsije të largohen nga DT.

Aneksin nr. 8 - PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM MJETET E PUNË
Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve Sasia
Eskavator me lug para dhe mbrapa me regjistrim valid min 8ton 1 Copë
Eskavator me kapacitet 9-10tone me atest 1 Copë
Ngarkues me pirun dhe kove me kapacitet 2-3 tone me atest 1 Copë
Damper me regjistrim valid min5ton 1 Copë
Makine ngjeshese 700-750kg. 1 Copë
Damper me kapacitet max 500tone 2 Copë
Kamion kiper me kran me peshe bartese 7- 9 tonë-me atest 1 Copë
Paisje (vakum) ngritese per anesore te betonit 500-600kg 1 Copë
Ndriques me gjenerator (4llampa) me kapacitet 1-2tone 1 Copë
Kompresor ajri 10bar-30Kw 1 Copë
Kompresor ajri 10bar-7.5Kw 1 Copë
Gjenerator 10Kw 1 Copë
Kove per perzirjen e betonit qe montohet ne eskavator me sistem hidraulik 0.25m3 1 Copë
Cilinder hidraulim me gjemba qe montohet ne eskavator ose luge ngarkues me kapacitet 400-500kg 1 Copë
Burgi qe montohet ne eskavator me shpime horizontale dhe vertikale 20-30kg per pajen e gropave per mbjelljen e drunjeve dhe shtyllave te ndriqimit 1 Copë

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kapese hidraulike qe montohet ne eskavator per mbjelljen e drunjeve me kapacitet 100-150kg 1 Copë
Minigreder qe monohet ne eskavator ose luge ngarkues me sistem hidraulik me kapacitet 100-150kg 1 Copë
Karroc elektrike kiper max 150kg 1 Copë
Ngjeshese papuqe e cila montohet ne eskavator me kapacitet 250-300kg 1 Copë
Fshese hidraulike qe montohet ne bobcat-luge ngarkuese max 200kg 1 Copë

VËMENDJE:
Krejt në fund, me shumë respekt duhet të potencojmë që nga analizimi i kërkesave të DT kemi gjetur se këto kërkesa në formën aktuale siç janë vendosur nga AK, si të tilla janë shumë të ngjashme edhe me DT të cilat tanimë janë të përfunduara dhe është lidhur kontrata. OE fitues i këtyre aktiviteteve të prokurimit ka qenë OE i njohur si "AAB" qoftë si i vetëm apo si GOE. Me fjalë të tjera, nga analiza e historisë së fundit të DT të publikuara nga AK, kemi konstatuar që sa herë AK i publikon këto kërkesa në DT (me ndonjë ndryshim kozmetik eventual për të mos u vërejtur hapurazi), gjithmonë në fund fitues rezulton që të jetë OE 'AAB'. Si shembull mund të marrim aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut në Lagjen 'Kalabria" faza III" me nr. 616-24-9998-5-2-1 nga AK – Komuna e Prishtinës. Pothuajse të njëjtat kërkesa kanë qenë të përcaktuara edhe në këtë DT ku në fund ka fituar AAB (edhe pse këto 2 aktivitet nuk janë identike për nga qëllimi dhe projekti). Pra edhe atje janë kërkuar ISO të panevojshme që i posedon vetëm AAB që s'kanë të bëjnë me projektin. Pastaj janë kërkuar inxhinier të ndërtimtarisë, hidros, arkitekturës, si dhe pajisje/makineri (etj) sikurse të bëhej fjalë për ndonjë project kompleks ndërtimor dhe jo për parqe ku do të mbillet gjelbërim dhe do të vendosen disa lodra për fëmijët.
Ngjashëm ka ndodhur në raste tjera ku ka fituar AAB në AK të tjera. Pra ka edhe raste tjera kur janë kërkuar ISO të panevojshme. Pastaj janë kërkuar inxhinier të ndërtimtarisë, hidros, arkitekturës, etj. Në fund është shpallur fitues AAB sepse vetëm ai i përmbushë këto kërkesa të DT.
Natyrisht që ndaj një fenomeni të tillë, ne si OE do të shfrytëzojmë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për të mbrojtur jo thjeshtë interesin e kompanisë tonë, por mbi të gjitha ligjshmërinë në këtë aktivitet të prokurimit publik. Kjo për arsye se po bëhet fjalë për buxhetin e shtetit i cili kur të shpenzohet, duhet të sigurojmë që të respektohet ligji në fuqi për prokurimin publik dhe të gjithë OE të trajtohen barabartë dhe jo të favorizohen një OE i caktuar duke diskriminuar të gjithë OE të tjerë. Për fillimin e kemi parashtruar këtë kërkesë për rishqyrtim dhe e kemi njoftuar KRPP. Nëse nuk do të shohim reflektim në kuptim të vendosjes së ligjshmërisë, do të parashtrojmë mjetet juridike edhe penale në organet kompetente ndaj personave specifik, pa cka se paralelisht do të kërkojmë edhe mbrojtje juridike civile dhe administrative.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimet ankimore, AK ka gjetur si vijon:

Lidhur me pretendimin nr. 1 – Miratohet pjesërisht ashtu që mbetet kërkesa 2.1. mirëpo largohet kërkesa 2.8 dhe 2.9. Kjo sepse të tri kërkesat ndërlidhen me inxhinier të ndërtimtarisë përkatësisht teknik të ndërtimtarisë. Për këtë projekt mjafton një inxhinier i ndërtimtarisë me 5 vite përvojë drejtimi konstruktiv sic është kërkuar në pikën 2.8. Ndërsa nuk ka nevojë për inxhinier tjetër apo teknik të ndërtimtarisë.

Lidhur me pretendimin nr. 2 – Miratohet pjesërisht ashtu që mbetet kërkesa 2.5 mirëpo largohet 2.13. Kjo sepse kërkesa 2.13 kërkon 2 teknikë të elektroteknikës ndërsa 2.5 kërkon 1 inxhinier të elektros me 5 vite përvojë. Në këtë projekt mjafton 1 inxhinier i elektros sikurse është kërkuar në pikën 2.5 dhe nuk ka nevojë për teknikët e kërkuar me 2.13.

Lidhur me pretendimin nr. 3 – Miratohet pjesërisht ashtu që mbetet kërkesa 2.15 ndërsa largohen kërkesat 2.3, 2.4 dhe 2.14 sepse janë të panevojshme për projektin dhe nuk përputhen askund me specifikat teknike apo paramasën. Sa i përket arkitektit sipas pikës 2.3, i njëjti është kërkuar edhe me pikën 2.2 të kërkesës prandaj nuk ka nevojë për 2 arkitekt në këtë projekt.

Lidhur me pretendimin nr. 4 – Miratohet pjesërisht ashtu që largohet kërkesa për certifikim me EN ISO 9712 2012 sepse nuk është certifikimi adekuat. Ndërsa pjesa tjetër e kërkesës " Një (1) person të certifikuar për saldim" vazhdon të mbetet në pikën 2.12.

Lidhur me pretendimin nr. 5 – Miratohet pjesërisht ashtu që vazhdon të qëndrojnë kërkesat për ISO 28001 2007; ISO 39001 2012 ndërsa largohen kërkesat për EN- 1090-1 2009+A1 2011 ISO 3834-2 2021; ISO 4063 2023. Sa i përket kërkesës për ISO 27001 2013, e njëjta vazhdon të qëndrojë mirëpo vetëm zëvendësohet me 27001 2022 pasi që sipas faqes ndërkombëtare ISO, standardi 27001 2013 nuk është më tutje i qasshëm dhe është zëvendësuar me 27001 2022.

Lidhur me pretendimin nr. 6 – Miratohet pjesërisht ashtu që:
Vazhdojnë të mbesin makineritë si vijon:

Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia
Eskavator me kapacitet 9-10tone (largohet pjesa "me atest")	1 Copë
Ngarkues me pirun dhe kove me kapacitet 2-3 tone (largohet pjesa "me atest")	1 Copë
Damper me regjistrim valid min5ton	1 Copë
Makine ngjeshese max. 750kg. (largohet pjesa min. 700 kg)	1 Copë
Damper me kapacitet max.500tone (pjesa max. 500 ndryshohet dhe behet min. 500).	2 Copë
Kamion kiper me kran me peshe bartese 7- 9 tonë-me atest	1 Copë
Kove per perzirjen e betonit qe montohet ne eskavator me sistem hidraulik 0.25m3	1 Copë

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Largohen makineritë si vijon:

Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia
Eskavator me lug para dhe mbrapa me regjistrim valid min 8ton	1 Copë
Paisje (vakum) ngritese per anesore te betonit 500-600kg	1 Copë
Ndriques me gjenerator (4llampa) me kapacitet 1-2tone	1 Copë
Kompresor ajri 10bar-30Kw	1 Copë
Kompresor ajri 10bar-7.5Kw	1 Copë
Gjenerator 10Kw	1 Copë
Cilinder hidraulim me gjemba qe montohet ne eskavator ose luge ngarkues me kapacitet 400-500kg	1 Copë
Burgi qe montohet ne eskavator me shpime horizontale dhe vertikale 20-30kg per pajen e gropave per mbjelljen e drunjeve dhe shtyllave te ndriqimit	1 Copë
Kapese hidraulike qe montohet ne eskavator per mbjelljen e drunjeve me kapacitet 100-150kg	1 Copë
Minigreder qe monohet ne eskavator ose luge ngarkues me sistem hidraulik me kapacitet 100-150kg	1 Copë
Karroc elektrike kiper max 150kg	1 Copë
Ngjeshese papuqe e cila montohet ne eskavator me kapacitet 250-300kg	1 Copë
Fshese hidraulike qe montohet ne bobcat-luge ngarkuese max 200kg	1 Copë

Makineritë që do të largohen si më sipër nga DT janë të panevojshme për projektin dhe nuk përputhen me ST/Paramasën respektivisht projektin sipas DT.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net